



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 385 Prot.

Patos më 30.10.2024.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 28.10.2024

I mbajtur sot më datë 28.10.2024 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë :

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Albiona Lamaj
2. Zejni Musaj
3. Shezair Sinananj
4. Novrus Toska
5. Eduart Faslliaj
6. Enkelejda Ajazi
7. Erald Çepele
8. Ertilla Myrtaj
9. Klarida Semanjaku
10. Suela Hoxhaj
11. Smerald Hazizaj
12. Renaldo Shpata
13. Klaudio Alisininaj
14. Artan Velçani

Takimi hapet nga Zv/kryetarja e Këshillit Znj. Albiona Lamaj.

Albiona Lamaj – Përhëndetje të gjithëve!

Në mungesë të kryetarit të këshillit mbledhjen e drejtoj unë si zv/kryetare e këshillit .

Në sallë ndodhen 14 (katërmëdhjetë këshilltarë).

Kështu që unë e deklaroj zyrtarisht mbledhjen e hapur.

Nisim me leximin e rendit të ditës.

1- Miratimi i rendit të ditës.

2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 30.09.2024.

3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 30.09.2024.

4- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Shtator 2024”.

5- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Shator 2024".

6- Projekt-vendim "Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo territoriale për Bashkinë Patos".

7- Projekt-vendim "Për dhënien në huapërdorje të një ambienti të ndodhur në pasurinë me nr. 104/2/A zk 3361 Sheqishte kati II, organizatës "Grupi vendor i veprimit Itea Patos", sipas planvendosjes bashkëlidhur".

8- Projekt-vendim "Për krijimin e komisionit këshillimor për medaljet dhe titujt vendorë të nderit".

9- Shqyrtimi i kërkesës së Z. Trifon Çapo për ndihmë financiare për shkak të sëmundjes së rënde të bashkëshortes së tij.

10- Të tjera.

Tek pika 10 ekzekutivi ka sjell për të kaluar në këshill një autorizim për përfaqësim në çështjen administrative, në çështjen gjyqësore që Bankers Petroleum ka hedhur ndaj bashkisë Patos ku i paditur është dhe këshilli bashkiak Patos, por më vonë do ta shpjegojmë që juristja e bashkisë Patos të përfaqësoj dhe këshillin bashkiak duke qënë se dhe ne jemi pjesë e paditur e çështjes.

Albiona Lamaj- Miratojmë rendin e ditës

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARE

Refaela Xeba



Smerold Hazizaj

ZV/ KRYETARE

Albiona Lamaj



Edmont Fazlija



Renelbe Shkoto





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3854 Prot.
/ 12

Patos më 30.10.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.10.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 30.09.2024.

Albiona Lamaj - Duke qënë se mbledhja e këshillit është audiovizive po ashtu me email u ka ardhur gjithë materiali i mbledhjes së kaluar.

Nëse ka ndonjë gjë për diskutim rreth procesverbalit të mbledhjes datë 30.09.2024 ? Nëse nuk ka kalojmë direkt në miratim.

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba

ZV/KRYETARI
Albiona Lamaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 385/13 Prot.

Patos më, 30 10.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.10.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 30.09.2024

Albiona Lamaj – Fjala për Refaelën!

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 30.09.2024

Refaela Xeba- Përshëndetje të gjithëve! Në mbledhjen e datës 30.09.2024 janë marrë gjithsej 6 vendime. Nga nr. 66 deri në nr 71.

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim.

Nga këto vendime vetëm njëri ishte me karakter normativ i cili është përcjell Prefekturës për verifikim të ligjshmërisë dhe ka ardhur përgjigja në përputhje me ligji. Gjithashtu dhe për vendimet e mbledhjes 17.09.2024 ju bëj me dije se erdhi përgjigja në përputhje me ligjin

Faleminderit!

SEKRETARI
Refaela Xeba

ZV/KRYETARI
Albiona Lamaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3842 Prot.
13

Patos më 30.10.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.10.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Shtator 2024”.

Albiona Lamaj – Fjala për ekzekutivin.

Barie Goxhaj- për muajin Shtator 2024 përfitojnë ndihmë ekonomike gjithsej 18 familje me një fond prej 71,976 (shtatëdhjetë e njëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë.

Familjet përfituese sipas listës dhe relacionit bashkëngjitur

Albiona Lamaj – Fjala për komisionin e ekonomisë.

Albiona Lamaj– Ka ndonjë pyetje? Diskutim?

Atëherë kalojmë në votim për miratimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba

ZV/KRYETARI
Albiona Lamaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3843/1 Prot.

3

Patos më 30 10.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Shtator 2024”.

Albiona Lamaj – Fjala për ekzekutivin.

Barie Goxhaj- nga fondei i kushtëzuara 6% janë gjithsej 16 familje me një fond prej 64,744 (gjashtëdhjetë e katërmijë e shtatëqind e dyzetë e katër) lekë

Albiona Lamaj Atëherë kalojmë në votim nëse nuk kemi diçka tjetër.

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba

ZV/KRYETARI
Albiona Lamaj

Bendito Shyqete



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3793 / Prot. 13

Patos më 30.10.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.10.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo territoriale për Bashkinë Patos”.

Albiona Lamaj – Fjala për ekzekutivin

Boreta Murati – Përshëndetje të gjithëve!

Pranë Bashkisë Patos është paraqitur kërkesa e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor ku kërkohet harta e përditësuar e kufijve administrativo-territorial, që përcakton standardet gjeohapësinore në kuptim të pikës 2, te nenit 93, të ligjit nr. 139/2015, i cili parashikon 5 rende kufijsh administrativo-territoriale.

Si nevojë për të patur një hartë të përditësuar të kufijve ndarës administrativo-territorial, kemi punuar hartën për njësitë administrative (rendi 4) dhe fshatrave apo njësive të tjera në përbërje (rendi 5).

Hartat e përgatitura nga ana jonë për secilën njësi administrative të Bashkisë Patos

1. Njësia Administrative Patos
2. Njësia Administrative Zharrëz
3. Njësia Administrative Ruzhdie

Kufiri i paraqitur është sipas hartave të përditësuara që ne disponojmë, për zona ende të pa azhornuara kufiri mund të jetë i ndryshueshëm. Zonat e paazhornuara janë fshatrat Rusinjë, Rerës, Margëlliç, Kasnicë dhe Siqec.

Në hartën e mësipërme janë të pasqyruara fshatrat me zonat kadastrale përkatëse dhe kufiri i ri është i paraqitur. Harta e qytetit Patos së bashku me Njësitë Administrative Zharrëz dhe Ruzhdie sipas kufijëve të arzhornimeve aktual. Në ngjyrë blu është kufiri i ri dhe në ngjyrë kuqe është kufiri i vjetër.

Kufiri i njësive sipas zonave kadastrale.

Në hartën e mësipërme është paraqitur kufiri i Njesisë Administrative Patos dhe fshatrave përreth : qyteti i Patosit (Zk 2890), fshati Dukas (zk 1567), fshati Kuqar (zk 2329),

fshati Grizë (zk 2411), fshati Banaj (zk 1094), fshati Rrerës (zk 3172), fshati Rusinjë (zk 2349), fshati Marglliç (zk 2594).

Në fshatin Rrerës, Rusinjë dhe Marglliç nuk ka kaluar ende procesi i regjistrimit fillestar dhe kufiri i paraqitur mund të jetë i ndryshueshëm në momentin e azhornimit

Harta 2 është Njësia Administrative Zharrëz dhe fshatrat e saj :kemi fshati Zharrëz (zk 3922), fshati Verbas(zk 1743), fshati Frashër (zk 1638), fshati Sheqishte (zk 3361), fshati Belinë (zk 1142).

Harta treguese e Njesisë Administrative Ruzhdie. Disa fshtatra në Njesisnë Administrative Ruzhdie nuk janë azhornuar, nuk ka kaluar procesi I regjistrimit fillestarë. Kufiri I tyre mund të ndryshoj në momëntin e azhornimit të zonës

Janë paraqitur fshati Ruzhdie (zk 3250), fshati Gjinoqarë (zk 1773), fshati Drenie (zk 1537), fshati Siqecë (zk 3457), fshati Kasnicë (zk 2111).

Harta e përditësuar e ndarjes administrativo-territoriale, të njësive administrative për Bashkinë Patos, duke qenë në kushtet që kemi ende zona të pa azhornuara të cilat ndodhen në kufirin ndarës me bashki të tjera kufiri aktual mund të pësojë ndryshime.

I kërkojmë Këshillit të Bashkisë Patos miratimin e Hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territoriale për rendin 4 dhe 5 dhe më vonë në momentin që do të kemi azhornime të zonave do paraqesim përsëri kufijë të azhornuar.

Erald Çepele- Kam një pyetje lidhur me zonën kadastrale Verbas për korrigjim mbase. Gjithë dokumentacionet që unë disponojë është zona 3743 kurse këtu është paraqitur nga ana juaj 1743. Dokumentacionet që ne kemi, në certifikatë pronësie që aktualisht e kam këtu zona kadastrale e Verbasit është 3743 kurse këtu është shënuar 1743.

Boreta Murati- Do ta shoh edhe njëherë nëse është bërë ndonjë gabim në shifër dhe nëse do të jetë gabim do ta rikorigjojmë.

Refaela Xeba- Për sqarim nëse ai është ndonjë lapsus kur të zbardhet vendimi do ta korrigojmë.

Eduart Faslliaj- Pse gjithë ky nxitim? Harta e paazhornuar, ne s'kemi bërë verifikime në terren, e ndryshueshme? Pse duhet të nxitojmë për ta miratuar? Ndërkohë që të marrim formën e prerë dhe e miratojmë. Kjo historia e ngjyrave më mirë mos ta kishit thënë se e kemi pa ngjyra por e lëm kështu, shkojmë në parim. Harta është e ndryshueshme, jo vetëm kufijtë nëpër fshatra po dhe vet kufijtë e bashkisë që mund të jëtë i ndryshueshëm. Atëherë pse duhet gjithë ky nxitim? Kufijtë e fshatrave mund të ndryshojnë? Kufiri i përgjithshëm i bashkisë mund të ndryshojë, pse do duhet ta miratojmë? Kur ne marrim përfundimisht momentin kur vjen dhe e miratojmë. E zëmë se e miratuam referuar kësaj harte ju si ekzekutiv do shkoni do formuloni dokumentacion, do mbani qëndrime të caktuara mbi një hartë që është e ndryshueshme dhe e interpretueshme. Nuk e kuptoj dot pse gjithë ky nxitim?

Boreta Murati- është një detyrim ligjor që ne na kërkohet nga Asig dhe ne jemi në limit të afateve. Siç e thash dhe më parë janë disa fshatëra të njësisë admisnistrative Ruzhdie që janë të paazhornuara ndërsa pjesa tjetër Zharrëza dhe Patosi pothuajse janë azhornuar që të gjitha dhe kufiri nuk do të ndryshojë. Për fshatrat të njësisë admisnistrative Ruzhdie do të ndryshojë në momentin që do të kaloj regjistrimi.

Eduart Faslliaj - Në dijeninë time kufijtë e fshatit Rusinjë, Margëlliç janë të paazhornuara janë të ndryshueshëm, që s'janë pjesë e njësisë Administrative Ruzhdie çka do të thotë që ka dhe fshtara të tjerë. Është tjetër gjë që ne na mbarojnë afatet ligjore dhe ne duhet të paraqesim një hartë me këtë dokumentacion që ju duhet të na e kishit sqaruar që në fillim. Unë e shoh pa vend që ne të miratojmë një hartë e cila do jëtë e ndryshueshme dhe për çdo rast që do ti referohemi do të jetë e interpretueshme.

Albiona Lamaj- Në faqen e parë të materialit shpjegohet qartë arsyeja dhe baza ligjore pse kërkohet, citohet dhe përcaktohet saktë që e kërkojmë për këtë arsye. Kështu që ajo pjesë e ligjit e cituar ka dhe afatet ligjore.

Eduart Faslliaj – sqarimet i jep ekzekutivi. Unë po i drejtohesha drejtoreshës dhe ajo e ka autorizimin të sqarojë. Materiali nuk është shtesues dhe sqarues mjaftueshëm.

Boreta Murati- për zonat që janë të paazhornuara ne kemi bërë dhe një kërkesë pranë Ashk- së për të filluar me regjistrimin fillesatar. Kështu që presim përgjigje nga Ashk. Kjo hartë është e përditësuar dhe do vazhdojë të ndryshojë deri në përfundim të regjistrimit.

Klaudio Alisininaj- Përditësimi i hartës prek sipërfaqen e territorit të bashkisë tonë? Ka ndryshim në sipërfaqe?

Boreta Murati- Po nëqoftë e shikon dhe te harta në faqen e dytë të relacionit ne kemi disa ndryshime kryesisht tek zona e Zharrëzës dhe pak te fshati Kuqar. Në të gjitha zonat ka pak ndryshime

Erald Çepele- Ky është një detyrim ligjor që kërkohet nga një institucion tjetër dhe harta sigurisht që do përditësohet, këtu mund të kemi ndryshim harte mesa shoh unë. Fshati Siqecë dhe Kasnicë që janë kufitarë me bashkitë e tjera. Kjo nuk i kërkohet vetëm bashkisë tonë, dhe duke qënë se po punohet më harta dixhitale dhe me disa projekte të tjera nga Ashk, këto janë kufijtë fillesatar sigurisht që do këtë ndryshime për të gjitha bashkitë. Rëndesi ka që po punohet

Orgest Gollosi- Nuk ndryshon sipërfaqja e bashkisë Patos sepse ndryshimi i kufijëve të qyeteve kërkon reforma admnisistrative. Këtu ju po miratoni një hartë të përditësuar të sipërfaqes së bashkisë Patos, fshtarve dhe zonave kadastrale. Kaloj azhornimi i Kuqarit po përditësohet harta dhe ju po miatoni një hartë të përditësuar. Kështu do vazhdojë dhe për zonat e paazhornuara.

Klaudio Alisininaj- me këtë përditësimin e hartës kemi ulje të metrave katrorë apo është i njëjti numër?

Orgest Gollosi- Sipërfaqja është e njëjtë.

Këshilltarja znj. Klarida Semanjaku largohet nga salla.

Eduart Faslliaj – Kisha unë një pyetje- është përcaktuar, azhornuar në terren kufiri midis bashkisë tonë dhe bashkisë Roskovec?

Orgest Gollosi- I ka kufijtë,

Eduart Faslliaj – Është azhornuar kufiri midis njësisë administrative Ruzhdie dhe pjesë së Roskovecit se në dijeninë time jo?

Orgest Gollosi- I ka të përcaktuar kufijtë natyror.

Eduart Faslliaj – them se kam informacion nga banorët, nga terreni atje që tokat bujqësore kanë mosmarrëveshje midis bashkisë së Roskovecit dhe bashkisë tonë. Për faktin se nuk është përcaktuar kufiri. Ka një shifër fikse të sipërfaqes të bashkisë Patos përfshirë dhe komunën

Orgest Golloshi- Shifra që ka qënë 82 km².

Eduart Faslliaj – Je i sigurt që kjo shifër nuk do ndryshoj?



Orges Golloshi -po sepse ndarjet më qytetet fqinje i ke me kufij natyror.

Eduart Faslliaj – Nuk janë në kufijtë natyror, nuk është maja e kodrës midis Roskovecit, ka shkuar në mes të kodrës. E kam informacionin e saktë nga terreni dhe kjo shifra 58 km² do ndryshojë a 82 sa ishte ca rëndësie ka. Nqoftë se është përcaktuar sipërfaqja totale e bashkisë, në qoftë se kjo na kërkohet për shkak se na mbarojnë afatet kohore hajd ta miratojmë dhe sa here që të bëjmë azhurnime të tjera do vijnë akte të kësaj natyre dhe do ta rimiratojmë, biem dakord në parim. Po në qoftë se nuk është kështu ne miratojmë në mënyrë definitive një hartë e cila do ndryshojë unë e shikoj pa sens.


Albiona Lamaj- Ju shpjegimin e dhatë që kjo duhet për shkak të afateve ligjore dhe për këshilltarët besoj është e kuptueshme. E hedhim në votim

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba



ZV/KRYETARI
Albiona Lamaj



Renaldo Shketa





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3888/3 Prot.

Patos më 30.10.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.10.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien në huapërdorje të një ambienti të ndodhur në pasurinë me nr. 104/2/A zk 3361 Sheqishte kati II, organizatës “Grupi vendor i veprimit Itea Patos”, sipas planvendosjes bashkëlidhur”.

Albiona Lamaj – Fjala për ekzekutivin

Nurkë Hazizaj- Pranë bashkisë Patos është depozituar kërkesa nr. 3888 prot., datë 23.10.2024 e organizatës “Grupi Vendor i Veprimit Itea Patos ” për dhënien në huapërdorje të një ambienti të ndodhur në pasurinë me nr. 104/2/a, zk 3361 në fshatin Sheqishte.

Sikurse e keni dhe informacionin GVV e miratuar dhe me pjesëmarrjen e bashkisë Patos është miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 83, datë 18.12.2023 Grupi Vendor i veprimit Itea Patos” është regjistruar si organizatë jofitimprurëse në Gjykatën e Tiranës me vendimin nr. 7428, datë 10.10.2024.

Kjo shoqatë për t’u regjistruar në Drejtorinë e Tatimeve ka të nevojshme pasjen e një ambienti për t’u përdorur si seli qendrore në mënyrë që të përfundojë edhe ana ligjore dhe regjistrimi i saj në të gjitha organet kompetente të Republikës së Shqipërisë. Në kushtet kur dhënia në huapërdorje të pasurive publike është një kompetencë e këshillit referuar nenit 54 pika e/1 i kërkojmë këshillit të bashkisë të miratojë dhënien në huapërdorje të një ambienti të ndodhur në pasurinë me nr. 104/2/a, zk 3361 me sipërfaqe 30.82 m2, në fshatin Sheqishte kati II, sipas planvendosjes bashkëlidhur, pa kundërshtëpërblim dhe për një afat të pacaktuar. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të përdoret për seli për aktivitetin e Grupit Vendor të Veprimit (GVV).

Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Patos, për nënshkrimin e kontratës së huapërdorjes më GVV Itea Patos.

Albiona Lamaj- Ky objekt që do të jepet në huaqera çfarë funksioni ka?

Nurkë Hazizaj – Ky objekt aktualisht është i lirë, nuk ka një funksion të caktuar. Është në pronësi të Bashkisë transferuar me vendim të këshillit të Ministrave

Klaudio Alisininaj- Komisioni i Ligjeve është mbledhur në datën 24.10.2024 dhe pasi shqyrtoj kërkesën e mësipërme konstatoj se përmbajtja e projektvendimit është argumentuar në përputhje me ligjin dhe bazën ligjore dhe vendosi ta miratojë atë pa asnjë ndryshim me 4 vota pro.

Eduart Faslliaj- Mesa kam idenë ky objekt do ti vihet në dispozicion një grupimi të caktuar i cili do shërbejë dhenie konsulence për fermerët. Pse është përcaktuar që të vendoset në njësinë administrative Zharrëz kur për bujqëjt e njësisë administrative Ruzhdie është shumë larg. Pse mos të kishte dy objekte ose të ishte në qënder të bashkise sepse atje i shërben vetëm asaj zone.

Nuk kam asnjë kundërshtim, le të vendoset një ambjent për sqarimet përkatëse por atje ku e keni përzgjedhur vendin nuk besoj se ju shërben

Nurkë Hazizaj- Duke qënë se ne jemi në përfundim të vitit kalendarik dhe të gjitha godinat dhe objektet që aktualisht bashkia ka në pronësi janë të dhëna me qera nuk kishim një objekt të lirë. Kjo bëhet për efekt regjistrimi që të regjistrohet tek Drejtoria e Tatimeve sepse një nga dokumentacionet kryesore është dhe pasja e një selie.

Albiona Lamaj- Nëse në një të ardhme mund të lirohen këto dheniet mund të krijohen dhe degë të tjera

Nurkë Hazizaj- Mund të krijohen dhe shoqëri të tjera nuk është e thënë se kjo është krijuar dhe kjo do qëndrojë.

Novrus Toska- Ne bëm shumë mirë si bashki që ngritëm një GVV por kjo GVV është micro, një gjë shumë e vogël. GVV do kishte kuptim po të ishte me Fierin etj. GVV kanë për qëllim të thithin projekte të huaja. Ishalla ecim përpara duke bërë projekte të reja.

Nurkë Hazizaj – Pjesë e kësaj GVV është dhe bashkia

Albiona Lamaj Atëherë kalojmë në votim nëse nuk kemi diçka tjetër.

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba



Smerodol Horriq


ZV/KRYETARI
Albiona Lamaj



Eduart Forlliqaj


Renelda Shyqete




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3849/13 Prot.

Patos më 30 .10.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.10.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për krijimin e komisionit këshillimor për medaljet dhe titujt vendorë të nderit”.
Albiona Lamaj- Në këtë rast KB Patos ka miratuar komision këshillimor për medaljet dhe titujt vendorë të nderit që ka pasur një afat kohor, ky afat ka mbaruar dhe ne duhet ta hedhim përsëri për ta miratuar

Ai ka qënë i përbërë nga 5 anëtar dhe ne menduam ti linim përsëri këta pesë anëtar si pjesë të komisionit këshillimor
Anëtarët kanë qënë

- Z. Artan Velçani
- Znj. Vjollca Kasaj
- Znj. Enkelejda Ajazi
- Z. Kozma Sako
- Z. Kastriot Beharaj

Nëse bini dakord të vendosim përsëri këta

Eduart Faslliaj- Me të njejtin afat kohor

Albiona Lamaj- Po sepse e përcakton ligji

Albiona Lamaj Atëherë biem dakord të lëmë këta 5 si anëtarë të këtij komisioni

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARI

Refaela Xeba

ZV/KRYETARI

Albiona Lamaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3854 / Prot. 10

Patos më 30 .10.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.10.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Shqyrtimi i kërkesës së Z. Trifon Çapo për ndihmë financiare për shkak të sëmundjes së rënde të bashkëshortes së tij.

Albiona Lamaj- Fjalën e ka komisioni. E kaluan në dy komsione dhe tek i Shëndetësisë dhe i Ekonomisë.

Erald Çepele- Po e marrë fjalën si anëtar I komisionit të ekonomisë, është bërë një kërkesë nga z. Trifon Çapo për ndihmë financiare për shkak të sëmundjes së rënde të bashkëshortes së tij. Nga informacioni që kemi ne ka kaluar paraprakisht në komsisionin e Ekonomisë ku ka pasur disa kërkesa dhe nga komisioni i shëndetësisë është parë e arsyeshme për shkak dhe të veçantisë së sëmundjes që ka zonja dhe ne e kemi vendosur që ti japim vlerën 150 mijë lekë të reja.

Ftoj ta miratojmë.

Albiona Lamaj- Diagnoza e zonjës është kancer në pankreas në stadin terminal në stadin terminal ndërsa rastët e tjera nuk përfshiheshin në statusin terminl ndaj i kaloj dhe komisionit të ekonomisë për vlerën.

Albiona Lamaj- Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba

ZV/KRYËTARI
Albiona Lamaj

Edmond For Çepo
[Signature]

Renaldo Shyoto
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3851 Prot.
14

Patos më 30.10.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.10.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dhjetë të rendit të ditës.

Të tjera

Albiona lamaj- pika 10 që është Autorizimi i znj. Nurkë Hazizaj, për të përfaqësuar Këshillin Bashkisë Patos në çështjen gjyqësore me objektin Shfuqizimi i pjesshëm i Vendimit nr. 58, datë 26.11.2021 'Për sistemin e taksave vendore me ndryshimet përkatëse', vetëm përsa i përket pjesës që rregullon tarifën e ndotjes së ambientit për shoqërinë Bankers Petroleum Duke qënë se të paditur përveç bashkisë Patos është dhe këshilli bashkiak i bashkisë Patos, duke qënë se dhe znj. Nurkë Hazizaj do përfaqësoj bashkinë Patos duhet ti japim një autorizim që të jemi dhe ne të përfaqësuar si këshill bashkiak po nga znj. Nurkë Hazizaj Shfuqizimi i pjesshëm i Vendimit nr. 58, datë 26.11.2021 'Për sistemin e taksave vendore me ndryshimet përkatëse',
Fjala për ekzekutivin

Nurkë Hazizaj- Duke qënë se çështja Gjyqësore e Bankersit u nda, ishin tre pika kryesore. Pika e parë për shfuqizimin e Vendimit të këshillit të bashkisë duke qënë se ne e kemi kundërshtuar dhe e kemi pretenduar si një akt normativ i kaloj për kompetencë funksionale Gjykatës së Apelit,

Përsa përket pjesës tjetër shfuqizimi i njoftim detyrimit është gjykuar nga Gjykata e Shkallës së Parë është marrë vendimi. Vendim i cili nga ana jonë është bërë kërkesë për korrigjim të këtij vendimi pasi ka një mospërputhje të vlerës për të cilën jeni informuar herë pas here nga Refaela për këtë fakt. Në kushtet kur akoma nuk është dhënë një vendim përfundimtar nga gjykata e shkallës së parë Lushnje mbi kërkesën për korrigjim të vendimit pasi do të shtohet dhe vlera me 8 milion të vjetra sepse ka pas një gabim material në llogaritje nga gjyqtari gjë të cilën ne e kemi kundërshtuar. Deri sa të jepet vendimi nga Gjykata e Shkallës së Parë në Lushnje nga shoqëria Bankers është bërë kërkesë për pezullim të procesit gjyqësor në gjykatën e Apelit. Bashkia është dakord që kjo çështje të pezullohet derisa të dali një vendim nga gjykata e apelit Lushnje. Por kërkohet dhe miratimi i këshillit në mënyrë që dhe bashkia, këshilli, Bankers të jenë në një mendje për ta pezulluar për një afat deri në 6 muaj deri sa të dali një vendim përfundimtar mbi vlerën që do të paguaj kompania Bankers mbi taksen e tarifës së ndotjes së mjedisit. Në seancën e parë këshilli ishte në mungesë u pa e nevojshme një autorizim, nese keni dëshirë për tmë autorizuar mua.

Eduart Faslliaj- Në një vendim këshilli ne kemi miratuar që tna përfaqësoj Kryetari i Bashkisë në gjyq

Albiona Lamaj- jo

Eduart Faslliaj- Kush na ka përfaqësuar ne në Gjykatë?

Albiona Lamaj- Kemi qënë në mungesë.

Nurkë Hazizaj- Kemi qënë në mungesë se duke qënë se asnjëri ska paraqitur interes. Gjyqi vazhdon edhe pse jeni në mungesë dhe unë duke qënë se mbroj interesat e bashkisë mbroj dhe interesat e këshillit. Të dyja palët jemi për të njejtin qëllim.

Eduart Faslliaj- Kam idenë se kemi dakorduar që tna përfaqësonte kryetari por gjithsesi kur kemi diskutuar këtu ju keni thënë se ne e kemi humbur gjyqin me Bankersin sepse ata janë Bankersi dhe janë të fuqishëm.

Nurkë Hazizaj- Jo nuk thash ashtu që e kemi humbur, e kemi fituar pjesërisht nga 41 milion të rinj që ishte e kemi fituar me 33 milion. Pasi u caktua një ekspert nga gjykata, bëri matjet në terren.

Vlera u ul për shkak të sipërfaqes që nxori eksperti, s'kam thënë asnjëherë që e kam humbur. Flas për 2022 që e kam përfaqësuar vet.

Eduart Faslliaj- mesa kam unë parasysh në kemi qënë në një situat që i kemi kërkuar më shumë Bankersit duke pretenduar se është rritur sasia e ndotjes dhe na kanë hedhur po ata në gjyq me një pretendim tjetër dhe na kishin bllokuar detyrimet e një viti. Kështu ka qënë?

Nurkë Hazizaj- Jo nuk i kemi paditur, Ata kanë bërë ankim administrativ pranë bashkisë. Komisioni i Apelit Tatimor e ka marrë në shqyrtim kërkesën e kompanisë Bankers dhe ka vendosur që tarifa do të ishte ajo që ishte njoftuar me njoftim detyrimin. Brenda afatave ligjore kompania Bankers ka bërë kundërshtimin e njoftim detyrimin në gjykatë duke kundërshtuar përveç njoftim detyrimin dhe vendimin e këshillit të bashkisë. Ketu del si rol aktiv dhe këshilli i bashkisë sepse është kundërshtuar në thelb vendimi i këshillit të bashkisë si një akt normativ.

Eduart Faslliaj - e thënë shkurt Bankersi na ka paditur ne dhe nuk është dakord me tarfishën e ndotjes. Dhe është zhvilluar gjyqi në shkallën e parë dhe ka fituar bashkia pjesërisht dhe kemi fituar dy çështjet e tjera. Ne kemi qënë të pa përfaqësuar si këshill bashkiak dhe gjyqi është zhvilluar në mungesën tonë dhe për fatin tonë të mirë kemi fituar?

Nurkë Hazizaj- Po nuk është vetëm këshilli . Është këshilli, bashkia dhe Komisioni i apelit Tatimor. Bahkia dhe komisioni Tatimor ka pasur 2 përfaqësues pavarësisht se jeni njoftuar herë pas here. Unë duke qënë se mbroj interesat e bashkisë mbroj dhe interesat tuaja.

Albiona Lamaj- Me njoftim zyrtar jemi njoftuar

Klaudio Alisananaj – Unë propozoj nëse s'ka diçka tjetër, është e drejtë ajo që tha Nurka por unë mendoj që ne të kemi një përfaqësues nga anetarët e këshillit.

Albiona Lamaj- Nëse dikush shpreh dëshirën padiskutim

Nurkë Hazizaj- Pavarësisht se do jeni me mua pjesë në proces dhe përfaqësuesi i këshillit do relatoj. Është e drejta juaj. Po fitoj bashkia fiton dhe këshilli.

Erald Çepele- Per sqarim lidhur me atë që tha Eduarti ne kemi bërë një autorizim vitin e kaluar për kryetarin e bashkisë për ta autorizuar që të lidhi kontratë marrëveshje me Bankersin me këste të gjyqit të kaluar të 2022 jo të këtij këshilli atë 2019 kur ka qënë. Unë jam dakord që këshillin ta përfaqësoj juristja e bashkisë.

Albiona Lamaj- Atëherë kush është dakord për të përfaqësuar znj. Nurkë në gjyqin e këshillit të bashkisë patos. .

Albiona Lamaj- Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba



ZV/KRYETARI
Albiona Lamaj



Renalda Shyti

Per

